



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëhap / Prodatur Received / Delivery	16 - 11 2020	0	viti god year
Organ / Rrjesa Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMGJKK	2608/2020		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.286/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.286/2020 të datës 06.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED], me adresë banimi rr "B. Koshare" nr.65 Pejë, kundër Aktvendimit me nr.02/112/01-76345/20 të datës 14.09.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Pejës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër protokolli 1990/2020 e datës 06.10.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 02/112/01-76345/20 i datës 14.09.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Pejës dhe anulohet procedura e rekrutimit sipas konkursit të datës 02.07.2020 me nr.reference RN000006092 të shpallur nga Komuna e Pejës për pozitën Zyrtar për përkthime 3.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Pejës për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërrmarjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

III. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED], ka aplikuar në konkursin me nr.reference :RN000006092 të shpallur më datën 02.07.2020 për pozitën Zyrtar për përkthime 3 në Komunën e Pejës, i cili ka marrë pjesë në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Për këtë pozitë kanë aplikuar nëntë (9) kandidat e pesë (5) prej tyre i kanë plotësuar kriteret e konkursit, katër(4) prej tyre me datën 28.07.2020 ju kanë nështruar testit me shkrim , intervista me gojë është zhvilluar me datën 07.08. 2020. Me datën 13.08.2020 Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka nxjerrë raportin për kandidatin më të suksesshëm për pozitën Zyrtar për përkthime 3.

Ankuesi i pakënaqur me përzgjedhjen e kandidates më të suksesshme me datën 24.08.2020 ka parashtruar ankesën me nr.02-112/01-76345 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Pejës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Pejës më datë 14.09.2020 ka nxjerrë Vendim me nr. 02-112/01-76345/20 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me nr. 02-112/01-76345/20 të datës 14.09.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Pejës, më datë 06.10.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 1990/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.10.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Pejës. Komuna e Pejës me datën 27.10.2020 ka dërguar Përgjigjen në ankesë bashkë me provat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1990/2020 të datës 06.10.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i MAP-it i datës 26.06.2020; Vendimi i datës 21.07.2020 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës; Kopja e konkursit me nr.01-111/01-0056276/20 i datës 02.07.2020; Kërkesë për punësim e datës 07.07.2020 për Naser Gjurka; Ankesa e datës 24.08.2020 me nr.02-112/01-76345 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Pejës; Aktvendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Pejës i datës 14.09.2020 me nr.02/112/01-76345/20; Kërkesë për qasje në dokumente Publike-Zyrtare e datës 21.09.2020; Përgjigje me shkrim dhe dërgimi i dokumentacionit të kërkuar i datës 23.09.2020; Kopja e testit me shkrim e datës 28.07.2020; Pyetjet e intervistës me gojë; Lista e aplikacioneve të pranuar; Procesverbal i Komisionit Përzgjedhës i datës 13.07.2020; Kërkesë për punësim për Bahrije Thaqi bashkë me këto shkresa: Diploma e datës 01.10.2012 me Nr.1420 e lëshuar nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë; Diploma e Masterit e datës 29.10.2015 e lëshuar nga Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"; Vërtetim i datës 06.07.2020 e lëshuar nga Zyra e përkthimeve NSIF "Studie Deutsch; Referencë e datës 14.07.2020 e lëshuar nga ARDI SH.P.K.; Pasqyra e llogarisë së trustit prej datës 01.01.2020-07.09.2020; Çertifikatat e trajnimeve; ; Kërkesë për punësim e datës 07.07.2020 për Naser Gjurka bashkë me këto shkresa: Diploma e datës 15.10.1987 me Nr.326 e lëshuar nga Fakulteti i Xehtarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë –Inxhinier i diplomuar i Metalurgjisë; të dhënat personale për përvojën e punës Referencë e datës 10.12.2018 nga Policia e Eulex-it; referencë e datës 18.03.2014; Vlerësimi i punës i datës 04.05.2018; Vlerësimi i punës i datës 07.12.2018; E-mail i datës 29.10.2020 ; E-mail i datës 04.11.2020 bashkë me këto prova: dëftesë pagesa për muajin qershor 2019; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 03.01.2019; Kontratë pune për kohë të caktuar prej datës 01.07.2017 deri më 31.12.2017 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 27.10.2020 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/85.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit ██████████ është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Komuna e Pejës gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Përkthime 3" është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se kriteret themelore të konkursit për këtë pozitë kanë qenë:

- **Diploma Universitare, me dy(2) vite përvojë pune në lëmin e përkthimeve;**
- **Njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe, boshnjake dhe anasjelltas;**
- **Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve(word, Excel, Power Point, Access).**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se Komuna e Pejës me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën "Zyrtar për përkthime 3"ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ka konstatuar se ky pretendim është i qëndrueshëm sepse në këtë rast procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin për shërbimin civil respektivisht me dispozitat e potencuara më lartë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se KPSHC me rastin e përzgjedhjes së kandidatit për pozitën "Zyrtar për përkthime 3 " në Komunën e Pejës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcakton se: **11.1"Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.** Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se KPSHC ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se KPSHC me rastin e përzgjedhjes së kandidates më të suksesshme për pozitën "Zyrtar i Përkthimeve 3 " në Komunën e Pejës, Bahrije Thaqi si kandidate e cila ka grumbulluar më së shumti pikë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë".** Kandidatja e përzgjedhur znj. Bahrije Thaqi posedon Diplomën e datës 01.10.2012 me nr.1420 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës –Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë dhe mori titullin bachelor i administrimit në biznes, Diplomën Master i Arteve në Administratën e Biznesit të datës 29.10.2015 në Universitetin "Haxhi Zeka"në Pejë, dhe ka këtë përvojë pune: prej datës 01.03.2014 deri më 01.05.2017 ka punuar si bashkëpunëtorë e jashtme përkthyesë e gjuhëve shqip-serbokroatisht dhe anasjelltas në Zyrën e Përkthimeve NSH "Studie Deuteh", prej datës 01.07.2017 deri më datën 30.06.2019 në Ardi SH.P.K. në Pejë përkthyesë shqip –serbisht dhe anasjelltas.Ndërsa nga dokumentacioni që kemi pasur në shqyrtim me rastin e vendosjes së kësaj ankesë mund të konstatohet se marrëdhënia e punës në këto organizata private nuk është e krijuar konformë dispozitave të ligjit të punës dhe legjislacioni në fuqi që rregullon çështjen e punësimeve nga

se për të krijuar një marrëdhënie të punës të rregullt duhet të egzistoj kontrata e punës e nënshkruar nga dy palët dhe se duhet të jenë të lajmëruar punëtorët në administratën tatimore dhe se për ta duhet të paguhet obligimet tatimore.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës konsideron në rastin konkretë që nuk janë respektuar dispozitat ligjore sa i përket punsimi në këto ndërmarrje private dhe se nuk konsiderohet marrëdhënie e rregullt e punës nga Bahrije Thaqi në këto dy ndërmarrje private pasi siq deklarua më lartë punsimi nuk është konformë legjislacionit të punës, sepse nga dëshmitë shihet se pasi është bërë publikimi i rezultatit të kandidatës së pranuar për këtë pozitë më datë 14/08/2020, nga shkresat e lëndës vërtetohet se kandidatja e pranuar për këtë pozitë nuk ka qenë e evidentuar në ATK si punëtoare e ndonjë kompanie dhe se për të nuk ka pasur të paguar asnjë tatim dhe kontribut në trust pensional dhe se pagesa e tërëishme në ATK sa i përket trustit pensional është bërë më datë 03/09/2020 dhe 04/09/2020 e që i bie rrethë 20 ditë më vonë nga shpallja e rezultatit final të kandidatës së pranuar në këtë pozitë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit me datën 04.11.2020 ka kontaktuar kompaninë ARDI SHPK për të vërtetuar se si i është bërë pagesa për punën e kryer kesh apo përmes bankës, me datën 04.11.2020 përmes e-mailit zyrtar është përcjellë një kopje e dëftesë pagesës në kesh për muajin qershor 2019, me datën 05.11.2020 poashtu përmes e-mailit zyrtar janë përcjellë dy kontrata: Kontratë pune për kohë të caktuar prej datës 01.07.2017 deri më 31.12.2017 dhe aneks i kontratës i datës 03.01.2019 Kontratë pune për kohë të pacaktuar, ndërsa trustin e ka paguar me datën 03.09.2020 dhe 04.09.2020, mbi bazë të kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës me rastin e përzgjedhjes së kandidatit /es më të suksesshme për pozitën Zyrtar i përkthimeve 3, në Komunën e Pejës ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nga se nga argumentet e mësipërme nuk mund të llogaritet si marrëdhënie e rregullt e punës kjo formë e punësimit kur në procesin e rekrutimit dhe në shpalljen finale të rezultatit kandidatja e pranuar nuk ka qenë e evidentuar në procedurë të rregullt pranë ATK-së si punëtoare e rregullt dhe se vetëm në këtë formë mund ti llogaritet përvoja e punës për pozitën që ka aplikuar dhe në asnjë mënyrë në formën si na janë prezentuar disa kontrata të punës nuk kanë fuqi ligjore përderisa nuk janë në harmoni me dispozitat ligjore që rregullojnë në marrëdhënie të rregullt të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit i cili pretendon se testi me shkrim i mbajtur me datën 28.07.2020 nuk është përpiluar në pajtim me nenin 36 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ku thuhet: Testimi me shkrim për kandidatët përmban 30 deri 50 pyetje, pjesa e njohurive të përgjithshme ku kandidatëve ju parashtrihen 3 deri në 5 pyetje në formë eseje nga 150 deri 250 ljalë, në rastin konkret janë parashtruar vetëm tri ese dhe dy pyetje të shumëfishta, pjesa e aftësive të përgjithshme dhe të personalitetit ku parashtrihen 10 deri 15 pyetje me përgjigje të shumëfishta dhe pjesa e njohurive që lidhet me vendin e punës ku kandidatëve ju parashtrihen 15 deri 23 pyetje ku 50% janë pyetje të shumëfishta e 50% në formë eseje ndërsa në këtë rast janë vetëm 12 pyetje 6 me përgjigje të shumëfishta dhe 6 në formë eseje, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstatoi se ky pretendim i ankuesit është i bazuar sepse testi me shkrim ka pas 29 pyetje.

Pretendim tjetër ankimor i ankuesit është se gjatë vlerësimit të testit me gojë dhe me shkrim kandidatja është vlerësuar me pikët maksimale. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se ky pretendim ankimor i ankuesit është i qëndrueshëm sepse me datën 03.11. 2020 përmes e-mailit zyrtar

kemi kërkuar nga menaxheri i personelit përgjigjet e sakta të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, po të njëjtën ditë menaxheri i personelit ka dërguar përgjigjet e sakta të testit me shkrim dhe me gojë por nuk i ka dërguar përgjigjet për pesë pyetjet e para të pjesës së tretë për të cilat ankuesi pretendon se nuk janë të sakta.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Pejës, me rastin e nxjerrjes së Aktvendimit me nr.02/112/01-76345 të datës 14.09.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 48 Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED];
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.286/2020.

Sabile Avdyli
Gabir Avdyli
Procesmbajtëse

Estref Shabani
[Signature]
Kryetar i Kolegjit